

17 dhjetor 2025,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2025, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.16/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB Bashkimi për regjistrimin e lojtarit Malcolm Ray Armstead si lojtar i lirë ("free agent")¹ jashtë afatit kalimtar.
- II. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave **REFUZON** kërkesën e KB Bashkimi për lejimin e regjistrimit të lojtarit Malcolm Ray Armstead.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

¹ **Lojtar i lirë (free agent)** – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.16/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Klubi KB Bashkimi ka paraqit kërkesë për regjistrimin e lojtarit Malcolm Ray Armstead si lojtar **të lirë (free agent) jashtë afatit kalimtar.**
- (b) Komisioni i Garave vëren se lojtari Malcolm Ray Armstead ka realizuar shkëputjen e kontratës me KB GO+ Peja, me klauzolë të përcaktuar se i njëjti nuk ka të drejtë loje në Kampionatin e Kosovës deri në afatin kalimtar dimëror. Duke pasur parasysh gjithashtu se KB Bashkimi tashmë ka regjistruar një lojtar, Muhamedali Janjeva, me status të lojtarit të lirë, konstatohet se nuk plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026.
Andaj, Komisioni i Garave refuzon regjistrimin e lojtarit Malcolm Ray Armstead për klubin KB Bashkimi.
- (c) Komisioni i Garave udhëzon që Malcolm Ray Armstead mund të regjistrohet për KB Bashkimi me të drejtë loje pas afatit kalimtar dimëror.

Komisioni i Garave:



Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës



KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.